



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 51
Prishtinë, më 1 mars 2012

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 1 E 2 MARS 2012**

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme,
4. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e pensionistëve dhe invalidëve të punës të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare,
6. Rekomandimi i Komisionit për Punë të Brendshme , Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së lidhur me vërejtjet e presidentes në ligjin nr. 04-L-76 për policinë.
7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme,
8. Shqyrtimi i Propozim- Statutit të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës,
9. Njoftimi me Përfundimin e Nënkomisionit për mandate, imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, lidhur me Mocionin procedural të GP të lëvizjes “Vetëvendosje”,

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, dhe

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Haki Demolli, Arsim Bajrami, Alma Lama, Ardian Gjini, Suzan Novoberdaliu, Vesna Mikiq, Rasim Demiri, Sabri Hamiti dhe Mursel Halili, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim për fjalë u paraqit deputeti **Visar Ymeri**, i cili u shprehu ngushëllime familjeve të dy të rinjve shqiptarë, të vrarë nga një polic maqedonas në qytetin e Gostivarit, më 28 shkurt 2012.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Valbona Dibra, parashtoi pyetje për ministrin Blerand Stavileci, në lidhje me kompetencat dhe rolin e Agjencisë Kosovare për Bujqësi, në zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Ministri Blerand Stavileci, iu përgjigj pyetjes së deputetes Valbona Dibra.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me ndërrimin e statutit të QKUK-së

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputeti Visar Ymeri, parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se kur është marrë vendimi që ai të takohet me presidentin e Serbisë, Boris Tadiq, e që sipas faqes së internetit WikiLeaks, ka ndodhur në vitin 2006, në Selanik dhe në vitin 2008, në selinë e OKB-së në New York.

Kryeministri Hashim Thaçi, nuk ishte prezent në sallë.

Deputeti Liburn Aliu, parashtoi pyetje për kryeministrin, në lidhje me atë se cilat ishin konkluzionet e takimeve që Hashim Thaçi ka pasur me presidentin e Serbisë, Boris Tadiq, e që sipas faqes së internetit WikiLeaks, ka ndodhur në vitin 2006 në Selanik dhe në vitin 2008 në selinë e OKB-së në New York.

Kryeministri Hashim Thaçi, nuk ishte prezent në sallë.

Deputeti Afrim Kasolli, parashtoi pyetje për kryeministrin, në lidhje me atë se cilët persona janë në dijeni të diskutimeve në takimet që Hashim Thaçi ka pasur me presidentin e Serbisë, Boris Tadiq, e që sipas faqes së internetit WikiLeaks, ka ndodhur në vitin 2006 në Selanik dhe në vitin 2008, në selinë e OKB-së në New York.

Kryeministri Hashim Thaçi, nuk ishte prezent në sallë.

Deputetja Kimete Bytyqi, parashtoi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar, në lidhje me arritjen e kriterit të barazisë gjinore në Shërbimin Civil të Kosovës.

Ministri Mahir Yagcilar, iu përgjigj pyetjes së deputetes Kimete Bytyqi.

Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, parashtroi pyetje për ministrin Blerand Stavileci, në lidhje me përkrahjen e Ministrisë që ai drejton për projektin për pyllëzimin e zonës së fshatit Restelicë, ku nga orteqet e borës u shkaktua tragjedia para pak ditësh.

Ministri Blerand Stavileci, iu përgjigj pyetjes së deputetes Afërdita Berisha-Shaqiri.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj, për arsyet e neglizhencës lidhur me projektin për ndërtimin e TC Kosova e Re.

Ministri Besim Beqaj, iu përgjigj pyetjes së deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj, për arritjet e deritanishme nga Plani i Banjskos.

Ministri Besim Beqaj, iu përgjigj pyetjes së deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve plenare të mbajtura më 31 janar dhe 15 shkurt 2012

Kuvendi miratoi, pa vërejtje,

procesverbalet e mbledhjeve plenare të datës 31 janar dhe 15 shkurt 2012.

4. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e pensionistëve dhe invalidëve të punës të Republikës së Kosovës

Kryesuesi në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, ftoi kryetaren e Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për prezantimin dhe arsyetimin e Raportit me rekomandime.

Suzana Novoberdaliu, fillimisht tha se kjo çështje paraqet një nga temat e rënda të trashëguara që nga periudha e pasluftës në Kosovë. Kjo kategori shoqërore ka të drejtë të gëzojë një mbikëqyrje dhe të drejta më të mëdha nga institucionet shtetërore, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Deputetja Suzan Novoberdaliu, më pas u fokusua në aspekte të tjera të çështjes së pensionistëve në Kosovë, për të cilat tha se kjo temë nuk është trajtuar asnjëherë me seriozitet, as në kohën e pranisë së misionit të OKB-së- UNMIK, në Kosovë, por edhe më vonë.

Ajo në vazhdim foli për Raportin e Komisionit që ajo drejton dhe i lexoi para Kuvendit rekomandimet e Komisionit lidhur me këtë çështje. Në fund i ftoi deputetët për miratim të këtij Raporti me rekomandime.

Ministri **Nenad Rashiq**, në emër të Qeverisë së Kosovës paraqiti në mënyrë kronologjike trajtimin e kësaj çështjeje nga ana e institucioneve përkatëse shtetërore.

Ai në lidhje me disa pika të Raportit me rekomandime të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, shfaqti bindjen se parimisht janë të mira, por sa i përket mundësive reale që lidhen me çështjet financiare dhe buxhetore kjo gjë në këtë fazë është vështirë të realizohet.

Nuk mund të bëjmë një ligj ideal, por duhet të insistojmë në përmirësimin gradual të gjendjes në këtë fushë, konstatoi ministri Nenad Rashiq.

Shaip Muja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se kjo çështje kërkon angazhim dhe përgjegjësi të përbashkët të të gjitha grupeve, kjo aq më parë kur dihet se Fondi i pensionistëve të Kosovës është plaçkitur nga Serbia në vitin 1999.

Ai propozoi që të krijohet një komision, siç tha, multidisiplinar i cili do të ndihmonte ministrinë përkatëse për adresimin e saktë dhe të qëndrueshëm të kësaj çështjeje, sepse siç dihet para pak kohësh, Kuvendi i Kosovës, Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti ia ka kthyer Qeverisë, për ripunim.

Rita Hajzeraj-Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se mbështesim peticionin e Koalicionit të pensionistëve të Kosovës si dhe rekomandimet e tyre.

Më tej ajo u fokusua në aspektet e gjendjes së rëndë sociale në Kosovë, për të kritikuar më pas përmbajtjen e Projektligjit për skemat pensionale, të cilin, kohë më parë Kuvendi ia kishte kthyer Qeverisë për ripunim.

Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj kërkoi që sa më parë të hartohet Projektligji për pensionistët dhe i njëjti të shqyrtohet në Kuvend.

Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se grupi që ai përfaqëson vlerëson se që nga periudha e pasluftës në Kosovë nuk ka sistem pensional të mirëfilltë, e rrjedhimisht nuk ka as kujdes për gjeneratën më të vjetër.

Ne duhet ta ndërtojmë një sistem pensional i cili bazohet në solidaritetin mes gjeneratave, pra zgjidhjen duhet ta gjejmë brenda nesh, theksoi ai.

Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se grupi që ai përfaqëson vlerëson se pensionistët kanë mbetur në gjendje të mjerueshme, si pasojë e mos avancimit të politikave sociale dhe ekonomike në Kosovë, që nga viti 2002.

Më tej ai theksoi se çështjen e Fondit Pensional të Kosovës, të grabitur nga Serbia, Qeveria e Kosovës është dashur ta shtrojë në bisedimet teknike me Serbinë, të cilat po mbahen që nga marsi i vitit 2011, në Bruksel.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se edhe grupi që ajo përfaqëson, vlerëson se do të duhej një bashkërendim më i mirë ndërmjet ministrisë së Punës dhe Mëriqenies Sociale dhe Ministrisë së Financave, për adresimin adekuat të kësaj çështjeje.

Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, tha se grupi që ajo përfaqëson konsideron se përkundër faktit se është arritur harmonizimi i qëndrimeve me Bankën Botërore dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar, lidhur me ndarjen e mjeteve buxhetore për këtë qëllim, prapëseprapë kjo çështje ende nuk është duke u zbatuar.

Më tej ajo shtroi nevojën e përgatitjes dhe miratimit, sa më parë që është e mundur, të Projektligjit për pensionistët, ndërsa rritja e pensioneve të bëhet në mënyrë retroaktive nga 1 janari i vitit 2012.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë deputetët:

Jakup Krasniqi, Suzan Novoberdaliu, Sabri Hamiti, Lumnije Morina, Albin Kurti, Time Kadrijaj, Jeton Svirca, Teuta Sahatqija, Ganimete Musliu, Aurora Bakalli, Donika Kadaj-Bujupi, Muhamet Mustafa, Lutfi Haziri, Shaip Muja, Fadil Demaku, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Halit Krasniqi, Visar Ymeri, Teuta Haxhiu, Goran Marinkiviq, Emilija Rexhepi, Flora Brovina, Hashim Dëshishku, Arsim Bajrami, Gëzim Kelmendi, Lirije Kajtazi, Hydajet Hyseni, Nazane Breca, Salihe Mustafa, Haki Demolli, Njazi Idrizi, Vjollca Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputetet Sala Berisha-Shala dhe Blerta Deliu- Kodra, thanë se diskutimet e tyre do t'i dorëzojnë me shkrim.

Në vazhdim kryetari paraqiti idenë që të hidhen në votim pikat nr. 1, 2 dhe 5 të rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për

këtë pikë të rendë të ditës, si dhe propozoi që Kuvendi, të themelojë një grup të ekspertëve për këtë çështje. Detyra e këtij grupi do të ishte themelimi i Fondit pensional. Në këtë drejtim kryetari paraqiti para deputetëve edhe disa propozime për linjat e mundshme buxhetore mbi bazën e të cilave do të mund të funksiononte ky fond. Diskutimi i tërësishëm i kryetarit është dhënë në transkript.

Më tej ai kërkoi deklarin e kryetarëve të grupeve parlamentare dhe të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, lidhur me propozimin e lartpërmendur.

Lidhur me këtë u deklaruan: në emër të GP të PDK-së, Hydajet Hyseni, në emër të GP të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër GP të lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, ndërsa në emër të GP të AAK-së, Ardian Gjini, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari në vazhdim hodhi në votim Raportin me rekomandime të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 43,
Kundër----- 47,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Kuvendi nuk miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, lidhur me peticionin e Koalicionit të Pensionistëve të Kosovës.

Në vijim kryetari propozoi që Kuvendi t’i mbyllë punimet për ditën e sotme, ndërsa vazhdimi i mbledhjes plenare të bëhet ditën e premte, më 2 mars 2012, në ora 10:00.

Kuvendi miratoi propozimin e lartpërmendur të kryetarit.

Kryetari konstatoi të mbyllur punimet nga mbledhja e sotme, ndërsa vazhdimi i saj, tha se do të bëhet më 2 mars 2012, në ora 10:00.

2 mars 2012, e premte ora 10:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare të filluar më 1 mars 2012

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar më 1 mars 2012 dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 64 deputetë.

Kryetari tha se për fjalë është paraqitur në emër të Qeverisë së Kosovës, zëvendëskryeministri Slllobodan Petroviq.

Zëvendëskryeministri **Slllobodan Petroviq**, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës kërkoi që pika nr. 11. - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë**, të hiqet nga rendi i ditës së sotme dhe të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Ai këtë kërkesë e arsyetoi për shkak të sqarimeve shtesë që duhet të bëhen për projektligjin, ndërsa propozimi i tij është bërë edhe pas konsultave me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryetari kërkoi deklarimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, lidhur me propozimin e zëvendëskryeministrit Slllobodan Petroviq.

Lidhur me këtë u deklaruan: në emër të GP të PDK-së, Adem Grabovci, në emër të GP të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të GP të lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të GP të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të GP të SLS, Sasha Millosavjeviq, ndërsa në emër të GP “6+”, Duda Balje, të cilët u pajtuan që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Kryetari kërkoi që Kuvendi përmes një votimi formal të deklarohet për propozimin e lartpërmendur.

Kuvendi miratoi propozimin që pika nr. 11. e rendit të ditës - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë**, të shtyhet për mbledhjen plenare të radhës.

Kryetari në vazhdim tha se në radhë është pika nr. 5 e rendit të ditës - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare**.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

Raportin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë, dhe Mirëqenie Sociale, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Fikrim Damka.

Për amendamentet nr. 4 dhe nr.5, në emër të Komisionit për Legjislacion, diskutoi, deputeti Arben Gashi.

Pasi që nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, dhe amendamentin nr. 13.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 74,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare.

6. Rekomandimi i Komisionit për Punë të Brendshme , Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së lidhur me vërejtjet e Presidentes në Ligjin nr. 04-L-76 për policinë.

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e ka shqyrtuar vendimin e Presidentes së Kosovës për kthim në Kuvend të ligjit nr.04/L-76 për Policinë dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Ahmet Isufi.

Pasi që nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, dhe amendamentin nr. 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

1. Miratohen amendamentet, sipas vërejtjeve të Presidentes së Republikës së Kosovës, në ligjin nr. 04/L – 76 për policinë.
2. Me ndryshimet e miratuara ligji konsiderohet i shpallur.

7. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme

Deputeti **Zenun Pajaziti**, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si Komision kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe Kuvendit ia kemi paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ai u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni funksional.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzeje Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputeti, Imri Ahmeti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	67,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Miratohet Raporti me rekomandime i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

8. Shqyrtimi i Propozim- Statutit të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës

Deputeti **Zenun Pajaziti**, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si Komision kemi shqyrtuar Propozim- Statutin e Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, dhe Kuvendit i kemi rekomanduar miratimin e tij.

Kryesuesi **Sabri Hamiti**, hapi debatin për shqyrtimin e Propozim- Statutit të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim- Statut dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Propozim- Statutit të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	68,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Miratohet Statuti i Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, sipas tekstit të propozuar me Rekomandim të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

9. Njoftimi me përfundimin e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, lidhur me mocionin procedural të GP të lëvizjes” Vetëvendosje”

Kryesuesi i njoftoi deputetët për përfundimin e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, lidhur me mocionin procedural të GP të lëvizjes “Vetëvendosje” nr. 04-DO-822, të 8 shkurtit 2012, lidhur me pretendimet për shkeljen e Rregullores së Kuvendit gjatë punimeve të mbledhjes së jashtëzakonshme, të mbajtur me 31 janar 2012.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Idriz Vehapi.

Pasi që nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe amendamentin nr. 21.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 11 : 15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale